

## **PËR PRINDËRIT**

### **Cfarë janë katër ditët e Punëtorisë së Shkrimit Kreativ Veror?**

Në partneritet me Ambasadën Amerikane dhe Këndet Amerikane, Shkrimtarët nëpër Shkolla (WITS) kanë nominuar poeten Marrilee Cunningham si Shkrimtare që do të qëndrojë në tre Këndet Amerikane. Programi WITS mundëson studim akademik të gjuhës në dy nivele: pasurim akademik dhe zhvillim personal.

### **Më tregoni më tepër për Shkrimtarët nëpër Shkolla.**

Ju lutemi vizitoni faqen e internetit: <http://www.witshouston.org/>. Mund t'i bashkangjiteni edhe WITS' blog-ut: <http://witsblog.org/>.

### **Cfarë do të bëjë fëmiju im në këtë program?**

Fëmiju yt do të punojë me shkrimtaren çdo ditë për dy orë për katër ditë rradhazi në Këndin Amerikan. Shkrimtara gjithashtu do të ketë edhe një arsimitare-ndihmëse. Ajo do të sjellë përralla dhe poezi nga kultura të ndryshme, duke inkurajuar kështu fëmijën të shkruaj në mënyrë kreative sipas këndvështrimit të tij. Edhe shkruarit më ngurrues i a dalin mirë në këtë program, duke shfrytëzuar fuqinë e imagjinatës së tyre. Edhe pse fëmiju duhet të dijë Anglishten bazë, ai ose ajo do të shkruajë në gjuhën amtare.

### **Pse shkrimi kreativ është i nevojshëm?**

Studimet tregojnë se përfshirja në art është e lidhur me:

- Performancën akademike më të lartë,
- Shërbimet për komunitetin, dhe
- Zvogëlim të ikjes nga orët e mësimi

Shkathtësitë e të shkruarit mirë jo vetëm që i ndihmon fëmijës të shkëlqejë në orët e gjuhës, por nëse shkathtësitë e të shkruarit përmirësohen, në të gjitha lëndët tjera ka përmirësime.

### **Doni të bëni diçka më tepër?**

Pasi që mësimi fillon në shtëpi, ja disa sugjerime për të inkurajuar fëmijën tënd të vazhdojë leximin dhe të shkruarit pas eksperiencës në WITS. Ju mund t'i lexoni me zë fëmijës tuaj në çfarëdo moshe. Gjithashtu fëmija juaj mund të:

- Të shkruaj një odë, poemë dedikuar personit më të dashur, vendit ose gjësendit,
- Të disajnojë ose shkruaj libër komik,
- Të bëjë drurin familjar dhe të shkruajë tregim qesharak për çdo farefis,
- T'i shkruajë letër autorit më të preferuar dhe t'i a dërgojë atë shtëpisë botuese,
- Të vendosni një synim për numrat e librave që fëmija do të dëshironte t'i lexojë për një muaj,
- Mbajeni një listë dhe shpërbleni fëmijën tuaj pasi ai ose ajo ka përfunduar atë, dhe
- Shkruani biografinë e mikut të tij/saj më të mirë